



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:133386

Datë: 15.12.2023

Numri i dokumentit: 05072506

P.nr.714/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, sipas Gjyqtarit të vetëm gjykues Veton Ademaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kaltrina Rexhepi - Imami, në çështjen penale kundër të pandehurit G.G., nga fsh. T. K. D. , i akuzuar për shkak të dy veprave të vjedhjes së rëndë nga neni 315 par.2, nën par.2.2, lidhur me par.1, nënpar.1.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë PP/II.nr.1436/20, të datës 16.10.2020, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datë 04.12.2023, në praninë e Prokurorit të shtetit L. H, të pandehurit G.G, së bashku me mbrojtësen e tij, av. P. Zh. të caktuar sipas detyrës zyrtare, përfaqësues i palës së dëmtuat F.H. sekretar i K. të B. I, me datë 07.12.2023 shpalli publikisht, ndërsa me datë 15.12.2023, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

G. (A) G, i lindur me datë...., në S, tani me vendbanim në fsh. T. K. D., i lindur nga babai A.G. dhe nëna V.G., e vajzërisë K., i identifikuar në bazë të numrit personal...., i pamartuar, recidivist, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në vuajtje të dënimit në Qendrën Korrektuese në Dubravë për vepra tjera penale.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e

I. Me datë 14.08.2020, rreth orës 01:15 minuta , në fsh. V, Rajoni I, K. P, pikërisht në Xhaminë e re ‘N..’, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore, merr pasurinë e ndërtesës fetare dhe atë të dëmtuarës – xhamisë së lartcekur , në atë mënyrë që i pandehuri shkon nga dera e pasme e xhamisë, fillimisht përmes lugës e cila u shërben gjematit për t’i veshur këpucët, hap derën, e pasi depërton brenda në xhami shkon te arka e parë e cila është e hapur dhe nga e njëjta merr shumën prej 15 euro, më pas shkon te arka tjetër e cila ka qenë e hapur dhe nga aty merr shumën prej 5 euro, vazhdon edhe te arka e tetë e pasi që e njëjta është e mbyllur, e hap me ndihmën e lugës dhe nga e njëjta merr shumën prej 25 euro, e pasi nisjet për të dal përmes derës kryesore , e vëren derën e zyrës së imamit afër, të cilën e hap me çelësin i cili gjendet në derën kryesore nga brenda, e pasi e hap derën hyn në zyre, ku pas librave të vendosura

në dollap , merr një gotë të plastikës e cila ishte e mbushur me të holla, e më pas largohet përmes derës kryesore pa u vërejt nga askush,

- me çka ka kryer veprën penale “*vjedhja e rëndë*” nga neni 315 par. 2 nën par. 2.2 lidhur me par. 1 nën par. 1.1 të KPRK-së,

II. Me datë 30.08.2020, rreth orës 12:56 minuta, në fsh. V. R., pikërisht në Xhaminë e re “N..”, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore, merr pasurinë e ndërtesës fetare dhe atë të dëmtuarës – xhamisë së lartcekur, në atë mënyrë që i pandehuri fillimisht depërton brenda në xhami përmes derës së pasme të cilën e hap me çelësin të cilin e gjen në dollapin e këpucëve, e pasi hyn brenda shkon në drejtim të arkës e cila ndodhet afër derës së hyrjes së xhamisë, e pasi arka ishte e mbyllur, then mikrofonin e xhamisë në vlerë prej 30 euro dhe me ndihmën e metalit të mikrofonit e hap arkën nga e cila merr të hollat në vlerë prej 20 euro, e më pas largohet nga vendi i ngjarjes pa u vërejt nga askush.

- me çka ka kryer veprën penale “*vjedhja e rëndë*” nga neni 315 par. 2 nën par. 2.2 lidhur me par. 1 nën par. 1.1 të KPRK-së

Gjykata konform nenit 7, 38, 39,40, 42, 69, 70, nenit 315 par.2, nënpar.2.2, lidhur me par.1, nënpar.1.1 të KPRK-së dhe nenit 364 të KPP-së të pandehurit i shqipton:

Për veprën penale si në pikën I të dispozitivit, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti

Për veprën penale si në pikën II të dispozitivit, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti

Konform nenit 76 të KPRK-së, të pandehurin e :

G J Y K O N

Dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 10 (dhjetë) muaj, të cilin dënim i pandehuri obligohet të e mbajë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet në paguarjen e shpenzimeve për paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet euro) €, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumën prej 20 (njëzet euro) €, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr. 1436/20 të datës 16.10.2020, ndaj të pandehurit G.G, për shkak të dy veprave penale “*vjedhja e rëndë*” nga neni 315 par.2, nën par.2.2, lidhur me par.1, nën par. 1.1 të KPRK-së.

Konform nenit 240 të KPP-së gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me datë 04.12.2023, në praninë e prokurorit të shtetit L. H, i pandehuri G.G, së bashku me mbrojtëse e tij, av. P .Zh. dhe përfaqësuesit të palës së dëmtuar F.H. - Sekretar i Këshillit të Bashkësisë Islame.

Gjykata konform dispozitave të nenit 241 të KPPK-së, ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast të i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe se për mbrojtës ka të angazhuar.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues pasi që është i bindur se i pandehuri ka kuptuar aktakuzën, i është dhënë mundësia që të deklarohet në lidhje me pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë e pranimit të fajësisë dhe pasojat e mospranimit.

I pandehuri G.G. deklarojë që pas konsultimit paraprak me mbrojtësen e tij av. P. Zh, pranoj fajësinë për të dy veprat penale të cilat i vihen në barrë, ndihet i penduar, dhe premtion se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale, duke kërkuar falje ndaj palës së dëmtuar, duke shtuar se pranimi është vullnetar pa kurrfarë presioni.

Prokurori i shtetit në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklarojë që pajtohet me pranimin e fajësisë, ky pranim fajësie është bërë në mënyrë vullnetare dhe ka mbështetje në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykatës i propozojë që të aprovojë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ndërsa rrethanë rënduese të merret fakti se në bazë të dhënave që ka për të pandehurin del që i njëjti ka kryer 26 vepra penale në lokacione të ndryshme, e kryesisht janë vepra penale të vjedhjes dhe vjedhjes së rëndë, e gjithashtu këto dy vepra penale kanë të bëjnë me vepra penale të vjedhjes së rëndë, që do thotë se i njëjti është recidivist i llojit të njëjtë të veprave penale.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar, deklarojë që e përkrahim në tërësi deklarimin e prokurores së shtetit sa i përket kërkesës pasurore juridike, i njëjti deklarojë që duhet të bisedojë me eprorin e tij, nëse do të ushtrojnë në kontest civil kërkesë.

Mbrojtësja e të pandehurit G.G, av. P. Zh., në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklarojë që pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, duke i propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të merr parasysh rrethanat lehtësuese siç janë kërkim falje, pendimi i tij dhe mosha e re, si dhe rrethanë posaçërisht lehtësuese siç është pranimi i fajësisë.

Gjyqtari i vetëm gjykues është i bindur se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 242 par. 2, nën par. 2.1, 2.3, 2.4 dhe par. 6 të KPPRK-së, pasi që të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: raporti fillestar i incidentit i datës 14.08.2020, nr. rasti....., raporti fillestar i incidentit i datës 30.08.2020, nr. rasti, raporti i policit T. K, i datës 14.08.2020, nr. rasti....., raporti i polices F. I, i datës 30.08.2020, nr. rasti....., deklarata e dëshmitarit R. Sh, dhënë në Stacionin Policor në V. K. P. dhënë me datë 14.08.2020, nr. rasti....., foto albumi 5 fletë gjithsejtë 9 fotografi, deklarata e dëshmitarit R. Sh, dhënë në Stacionin Policor në V. K. P. me datë 30.08.2020, nr. rasti, deklarata e palës së pandehur G.G, dhënë në Stacionin Policor në Pejë, me datë 02.09.2020, nr. rasti....., ..., si dhe shkresat e tjera bashkëngjitur lëndës, andaj gjykata konform nenit 242 par.2 dhe par.6, të KPPRK-së mori aktvendim me të cilin miratohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit për

të dy veprat penale "vjedhja e rëndë" nga neni 315 par.2, nënpar.2.2, lidhur me par.1, nën par. 1.1 të KPRK-së.

Me faktet e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit G.G. qëndrojnë të gjitha elementet e të dy veprave penale "vjedhja e rëndë" nga neni 315 par. 2 nën par. 2.2 lidhur me par.1, nën par. 1.1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të të pandehurit G.G, ashtu që i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë së të pandehurit i njëjti është i vetëdijshëm për veprat e kryera dhe ato i ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata ka konsideruar: pranimin e fajësisë, keqardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurit, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale, kërkim faljen, moshën e re, ndërsa rrethana rëndues ndaj të pandehurit gjykata gjeti se i njëjti është përsëritës i veprave penale kjo vërtetohet nga të dhënat e Sistemi Qendror Kombëtar të evidencës penale edhe atë : për veprën penale me numër të lëndës PM-348/17, dënuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë i plotfuqishëm me datë 15.06.2018, për lëndën me numër PM-183/18, dënuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, i plotfuqishëm me datë 11.10.2018, për lëndën me numër PM-232/2018, dënuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, i plotfuqishëm me datë 10.04.2019, për lëndën me numër P-371/20, dënuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, i plotfuqishëm me datë 07.01.2021, për lëndën me numër P-262/20, dënuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë- Dega në Glllogoc i plotfuqishëm me datë 11.11.2020, për lëndën me numër P-186/20, dënuar nga Gjykata Themelore në Gjilan, i plotfuqishëm me datë 07.04.2021, për lëndën me numër P-93/21, nga Gjykata Themelore në Mitrovicë Dega në Vushtrri, i plotfuqishëm me datë 30.06.2021, për lëndën me numër 2021:035264, nga Gjykata Themelore në Ferizaj, i plotfuqishëm me datë 25.08.2021, për lëndën me numër P-67/21, nga Gjykata Themelore në Prishtinë- dega në Glllogoc i plotfuqishëm me datë 27.07.2021, për lëndën me numër P-282/20, nga Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Istog, i plotfuqishëm me datë 22.04.2021, në lëndën penale P-715/2019, nga Gjykata Themelore në Prishtinë -Dega në Lipjan, i plotfuqishëm me datë 16.08.2021, në lëndë penale me numër 2021:040898, nga Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Ferizaj, i plotfuqishëm me datë 23.09.2021, për lëndën me numër P-279/20, nga Gjykata Themelore në Ferizaj -Dega në Kaçanik, i plotfuqishëm me datë 24.11.2021, për lëndën me numër P-84/21, nga Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë, i plotfuqishëm me datë 04.11.2021, për lëndën me numër P-129/21, nga Gjykata Themelore në Mitrovicë –dega në Skenderaj, i plotfuqishëm me datë 04.11.2021, për lëndën me numër P-48/21, nga Gjykata Themelore në Gjilan- dega në Kamenicë i plotfuqishëm me datë 02.02.2022, për lëndën me numër P-224/2021, nga Gjykata Themelore në Gjilan, i plotfuqishëm me datë 04.03.2022, për lëndën me numër P-266/21, nga Gjykata Themelore në Gjilan, i plotfuqishëm me datë 19.05.2022, për lëndën me numër P-256/21, nga Gjykata Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan, i plotfuqishëm me datë 26.04.2022, për lëndën me numër P-243/20, nga Gjykata Themelore në Gjakovë - dega në Malishevë, i plotfuqishëm me datë 28.07.2022, për lëndën me numër P-157/20, nga Gjykata Themelore në Gjakovë - Dega në Malishevë, i plotfuqishëm me

datë 17.10.2022, për lëndën me numër P-597/20, nga Gjykata Themelore Dega në Gjiilan –Dega në Viti, i plotfuqishëm me datë 26.01.2023, në lëndën me numër 2020:155689, nga Gjykata Themelore Gjakovë- Dega në Rahovec, i plotfuqishëm me datë 29.08.2023.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6, të KPPRK-së, gjykata ka përcaktuar për shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 20 (njëzetë) euro, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj.

Duke u bazuar në nenin 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.9 të KPPRK-së dhe nenit 36 par.1, 2, 3, nën par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, e obligoi në pagesën e taksës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, gjykata e përpiloj këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.714/20, datë 15.12.2023

Bashkëpunëtore profesionale
Kaltrina Rexhepi - Imami

GJYQTARI
Veton Ademaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa,
në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.